



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	03-02/24/18
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Data Datum Date	12-01-2018
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.01.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. *AKK-03-02-3740-17*, për Zyrтарin e lartë z.*Arsim Berisha*–Kryesues i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. *AKK-03-02-3740/17*, për Zyrтарin e lartë, z.*Arsim Berisha*, Kryesues i Bordit në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit i ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.*Arsim Berisha*(*DPK-03-02-3842-17*), dhe pastaj ai është kontaktuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, me ç'rast në takim zyrtar është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.*Berisha* është deklaruar se brenda afatit të caktuar nga Agjencia, do të bëjë ndryshimet e nevojshme, dhe do të sjell informacionet në Agjenci.

Ndërkohë, z.*Berisha*, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë informacionet (mbi ndryshimet në bizneset; “Doimo Mobilie” sh.p.k., “Bar Italia” sh.p.k., ”Beta Investment” sh.p.k., “Mercurio Medical” sh.p.k., “Moda Center” sh.p.k. të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në



Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z.Arsim Berisha tashmë ka hequr dorë nga funksionet menaxhuese në bizneset private, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shqip Havolli /

